



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 95-të të mbajtur më 15.11.2023, ka miratuar sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-8188/1 nga 19.09.2022, me pretendime për favorizim të kandidatit në procedurën e shpalljes për punësim, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve të caktuar në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare dhe nuk ka mundësi për të dhënë informacion shtesë në lidhje me pretendimet në aplikim për shkak se parashtruesi është i panjohur.

Lënda me numër 12-8188/1 nga 19.09.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 12-8188/1 të datës 19.09.2022 është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i panjohur me pretendime për favorizim ndaj kandidatëve në procedurat pas shpalljeve për punësim dhe është konstatuar rasti me numër 12-8188/1 datë 19.09.2022.

Në denoncim, parashtruesi shpreh pakënaqësinë e tij për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve në disa procedura për shpalljet e punësimit në të cilat ka aplikuar. Në të njëjtën kohë, pa treguar konkurse konkrete dhe pa treguar parregullsi të veçanta në veprimet e zyrtarëve të caktuar, parashtruesi parashtron pretendime se përzgjedhja e kandidatëve në procedurat për konkurset për punësim për të cilat ka aplikuar është bërë në bazë të lidhjeve partiake dhe familjare. Në të njëjtën kohë, parashtruesi, pa përmendur njoftimet, vuri në dukje disa parregullsi në procedurat pas njoftimeve të kryera nga disa institucione, si dhe bëri pretendime të përgjithshme për parregullsi në rishpërndarjen nga një vend pune në tjetrin brenda një ose më shumë institucioneve.

Në denoncim, parashtruesi tregoi vetëm një shpallje publike specifike - numrin e shpalljes publike /// të ///2022 për punësim në /// në ///, ku ai bëri pretendime për favorizim të personave të caktuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK konstatoi se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, pa specifikuar persona konkretë, ndërsa nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar pretendimet e denoncuar dhe nuk ka mundësi për të dhënë informacion shtesë për faktin se parashtruesi i denoncimit është i panjohur.

Lidhur me pretendimet lidhur me procedurën pas shpalljes publike me numër /// të ///2022 për punësim në /// në ///, parashtruesi nuk ka deklaruar në denoncim se si kandidat në procedurë ai ka paraqitur ankesë ose kundërshtim në organin kompetent.

Rrjedhimisht, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Përgatiti: A.R.M.

Miratoi: N.B anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**  
**Kryetar,**  
**Biljana Ivanovska**